



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.
____.____.2021

Tiranë, më

VENDIM
Nr. 212, datë 26.05.2021

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARIT ENTON
DHIMITRI, ME QËLLIM GRADIMI, PËR PERIUDHËN E VLERËSIMIT 2013-
2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit Enton Dhimitri, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relator z. Erjon Muharremaj,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional me qëllim gradimi, të gjyqtarit Enton Dhimitri, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

RAPORT

VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL ME QËLLIM
PËRCAKTIMIN E NIVELIT TË VLERËSIMIT (GRADIMIN)
E GJYQTARIT ENTON DHIMITRI

Ekstrakt

POLI I DREJTËSISË

RRUGA "ANA KOMNENA"

TIRANË

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtarit bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtarit pikëzohet sipas dy treguesve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Subjekti i rivlerësimit Enton Dhimitri, ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ai identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në funksion të zgjidhjes së drejtë të çështjes identifikon rastet kur hetimi gjyqësor nuk është kryer i plotë në shkallën e parë dhe vendos kryerjen e hetimit të pjesshëm në gjykatën e apelit (shih dokumentin 2). Tregon rastet kur ligji procedural e material është interpretuar gabim nga gjykata e shkallës së parë dhe sqaron se cili është kuptimi i saktë i përmbajtjes së normës konkrete (shih dokumentin 1 dhe nr. 2). Identifikon rastet kur një provë e marrë në procesin e hetimit penal është e papërdorshëm për shkak se është marrë në kundërshtim me dispozitat urdhëruese të K.Pr.Penale (shih dokumentin 3)”*.

Nga analiza e të gjithë burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes: Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtari përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim, si gjatë gjykimit në shkallë të parë, ashtu edhe gjatë gjykimit në apel, në ato çështje kur gjykata e apelit ka vendosur që të përsërisë pjesërisht shqyrtimin gjyqësor të çështjes.¹

Duke u nisur nga mënyra se si janë inkorporuar rrethanat e çështjes pothuajse në të gjitha vendimet të analizuara, vlen të theksohet se pavarësisht natyrës së gjykimit (*gjykim civil, gjykim penal themeli, apo kërkesë penale*), apo llojit të gjykimit të zhvilluar (*gjykim i zakonshëm ose i shkurtuar në gjykimet penale, apo gjykim si shkallë e dytë mbi bazë ankimi në çështjet civile*), rrethanat e fakteve parashtrohen në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit.

Konstatohet se në përgjithësi, gjyqtari i kushton rëndësi nxjerrjes së faktit juridik (*civil apo penal*), fakt ky, i cili nuk i referohet vetëm asaj çfarë kanë prezantuar palët në pretendimet apo prapësimet e tyre, por në përputhje dhe i integruar me provat e administruara gjatë gjykimit. Konstatohet “në përgjithësi”, pasi në disa vendime gjyqësore, rrethanat e çështjes pasqyrohen shkurt, kjo e kushtëzuar nga shkaqet e ankimit ndaj vendimit (*p.sh kur pala ankuese ankimon vendimin e shkallës së parë vetëm përse i përket masës së dënimit dhe jo në lidhje me ekzistencën apo jo të faktit penal*).² Faktet e çështjes gjithashtu nuk gjejnë pasqyrim në vendim në ato raste kur gjatë gjykimit në shkallë të dytë, pala ankuese ushtron të drejtën për të hequr dorë nga ankimi, referuar faktit se gjykata e apelit shqyrton çështjen objekt mosmarrëveshje mbi bazë ankimi të palëve ndaj vendimit të shkallës së parë.³ Gjyqtari tregon kujdesin e duhur, që në mbështetje edhe të nenit 16 të K.Pr.Civile të bëjë një cilësim të saktë të fakteve dhe veprimeve (*të ngjarjeve dhe veprimeve që përbëjnë fakte juridike*) që lidhen me mosmarrëveshjen objekt shqyrtimi. Kjo vëmendje evidentohet p.sh në vendimin civil nr. 20-2015-337/200 datë 10.04.2015, në të cilin gjyqtari i bën një vlerësim të ndryshëm provave të paraqitura nga palët dhe duke i analizuar ato del në një konkluzion të ndryshëm nga gjykata e shkallës së parë. I njëjti konstatim vërehet edhe në vendimin nr. 20-2016-151/99, datë 22.02.2016, në të cilin gjykata, duke përsëritur pjesërisht shqyrtimin gjyqësor dhe duke i bërë një analizë provave të lejuara dhe të marra në shqyrtim, konkludon ndryshe nga shkalla e parë në lidhje mungesën e interesit të ligjshëm të paditësit për ngritjen e padisë.

Në lidhje me identifikimin e natyrës së çështjes: Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve, pra, nëse natyra juridike e çështjes është civile, administrative apo penale. Gjyqtari i jep rëndësinë e duhur përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pasi ky përcaktim ka lidhje të

¹Vendimi nr.20-2016-151/99, datë 22.02.2016; vendimit nr. 20-2015-337/200, datë 10.04.2015 dhe vendimi nr. 20-2015-311/184, datë 03.04.2015;

²Vendimi nr.20-2015-881/246, datë 23.09.2015 dhe vendimi nr. 20-2016-47/06, datw 22.01.2016;

³ Vendimi nr. 20-2015-1250/727, datë 18.12.2015;

drejtpërdrejtë me kompetencën lëndore dhe përbën një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë, konform nenit 467 paragrafi i parë, shkronja “a” të K.Pr.Civile. Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtari dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë duke e shprehur në mënyrë eksplicite, gjyqtari e përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi.

Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm: Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari identifikon dhe citon ligjin e zbatueshëm, duke treguar gjithashtu kujdes në mos citimin apo listimin e dispozitave ligjore materiale të cilat nuk kanë lidhje dhe nuk të referojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt shqyrtimi. Duke i ndarë vendimet gjyqësore objekt vlerësimi në dy kategori (i) vendime civile dhe (ii) vendime penale, në lidhje me identifikimin e ligjit të zbatueshëm material, por edhe atij procedural të evidentuar për zgjidhjen e problemeve dhe situatave procedurale, konstatohet se:

(i) Në vendimet civile (*mosmarrëveshje pronësie, shpërblim dëmi, pavlefshmëri testamenti apo vërtetim i urdhrin të mbrojtjes*), gjyqtari identifikon ligjin material të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, duke iu referuar jo vetëm dispozitave materiale të Kodit Civil, por edhe ligjeve organike përkatëse. Në vendimin me objekt vërtetimin e urdhrin të mbrojtjes, gjyqtari identifikon ligjin e posaçëm të zbatueshëm, në rastin konkret ligjin nr. 9669, të vitit 2006, “Mbi marrjen e masave ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, duke u ndalur tek nenet 1, 10/c, 10/ë dhe 14 të këtij ligji. Në çështjen me objekt “shpërblim i dëmit jopasuror”, gjyqtari, përpos identifikimit të neneve 608, 609 dhe 625 të K.Civil për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, i referohet edhe ligjit nr.97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, gjyqtari identifikon dispozitat materiale relevante (nenet 360, 361, 371, 379, 407, 412 të K.Civil) për të përcaktuar pavlefshmërinë e testamentit dhe rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë absolute të tij, në vendimin nr. 20-2015-811/482, datë 07.09.2015.

Nuk konstatohet që gjyqtari të citojë dhe analizojë dispozita procedurale civile lidhur me juridiksionin dhe kompetencën e gjykatës, pasi këto çështje nuk rezultojnë që të jenë bërë objekt i ankimit dhe shqyrtimit gjyqësor.

(ii) Në vendimet penale, gjyqtari identifikon dispozitat materiale penale të sanksionuara në Kodin Penal, në funksion të analizimit dhe vlerësimit që i bëhet cilësimit juridik të faktit penal që i atribuohet të pandehurit. Konkretisht, gjyqtari identifikon nenin 283/1 të K.Penal në lidhje me cilësimin juridik të veprës penale të “Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve”,⁴ identifikon nenin 150 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Shkatërrimit të pronës”, nenin 199 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Shpërdorimit të tokës”,⁵ nenin 237 të K.Penal në lidhje me akuzën e “Goditjes për shkak të detyrës” apo nenin 236/2 të K.Penal në lidhje me “Kundërshtimin e punonjësit të policisë së rendit publik”,⁶ etj. Në

⁴ Vendimi nr. 20-2015-881/246, datë 23.09.2015;

⁵ Vendimi nr. 20-2014-637/176, datë 09.09.2014;

⁶ Vendimi nr. 20-2016-47/06, datë 20.02.2016;

çdo rast, referohen dispozita të Kodit Penal, të pjesës së posaçme në lidhje me veprat penale për të cilat procedohet, si dhe dispozita të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit (*neni 47 i K.Penal*). Evidentohet gjithashtu citimi i dispozitave procedurale penale (*neni 329 i K.Pr.Penale*) në lidhje me ankimin ndaj vendimit të pushimit të procedimit penal, etj.⁷

Nga ana tjetër, në vendimet gjyqësore burim vlerësimi, nuk konstatohet që të jetë evidentuar nga gjyqtari ndonjë rast konflikt i normave ligjore për të evidentuar mënyrën dhe se si do të gjente zbatim një konflikt i tillë në rastin konkret.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, në identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, në citimin dhe analizën e normave respektive, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Ai përdor parimet e përgjithshme të teorisë të së drejtës, siç është parimi i gjësë së gjykuar (shih dokumentin 1) apo parimin, sipas të cilit barra e provës në procesin penal i takon prokurorit (shih dokumentin 3). Kur është rasti, në funksion të zbatimit të ligjit ai përdor referenca nga jurisprudenca unifikuuese e Gjykatës së Lartë (shih dokumentin 2 dhe dosjen 2), merr masa për zbatimin e detyrave të lëna nga Gjykata e Lartë në rigjykim (shih dosjet 3 dhe 4). Zbaton drejtpërdrejtë dispozitat e Kushtetutës dhe të KEDNJ-së në rastet kur parashkrimet e këtyre akteve juridike janë të zbatueshme në zgjidhjen e çështjes konkrete*

⁷Vendimi nr. 20-2014-409/119, datë 03.06.2014.

(shih dokumentin nr. 2). Një rëndësi të veçantë i kushton edhe respektimit ose jo të dispozitave nga gjykatat më të ulëta, por nuk janë evidentuar raste të prishjes së vendimeve të shkallës së parë dhe kalimi të çështjes për rigjykim. Tre dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmojnë njohuritë e gjera të tij, që përfshijnë të drejtën civile të detyrimeve (shih dokumentin 1), shpërblimi i dëmit jashtëkontraktor (shih dokumentin 2), të drejtën e pronësisë (shih dosjet 3 dhe 4) dhe e drejta familjare në aspektin e mbrojtjes nga dhuna në familje (shih dosjen 5). Ai ka njohuri edhe në të drejtën penale, ku kombinon mirë rregullat e pjesës së përgjithshme me ato të pjesës së posaçme të Kodit Penal (shih dokumentin 3). Gjithashtu, ai ka njohuri edhe në të drejtën procedurale penale, konkretisht për procedurën e shqyrtimit të vendimeve të prokurorit gjatë hetimit paraprak (shih dosjen 1) dhe për masat e sigurimit (shih dosjen 2)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, rezulton se:

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale - civile apo penale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtari lidhur me zbatimin e saj.

Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk bëhet pa e shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen.

Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarit sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtari kryesisht interpreton normën ligjore konkrete ndaj faktit juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, duke nxjerrë konkluzionin e tij në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm

(i) Në vendimet civile: Përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet se:

- Në përcaktimin e pavlefshmërisë absolute të testamentit, gjyqtari interpreton për këtë qëllim dispozitat e përgjithshme të Kodit Civil në lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve të paaftë për punë (neni 371 i K.Civil) , rezervën ligjore (neni 379 i K.Civil), pavlefshmërinë absolute të këtij veprimi juridik (neni 407 në lidhje me nenin 92/a të

K.Civil), si dhe rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë absolute (nenet 411 dhe 412 të K.Civil).⁸

- Interpreton nenin 450 të K.Civil në raport me dispozitat e tjera të K.Pr.Civile (nenet 479, 150, 297 dhe 615) që trajtojnë nocionin e pezullimit të një gjendjeje të caktuar dhe në interpretim të këtyre dispozitave, në ndryshim nga gjykata e shkallës së parë, gjyqtari vlerëson se pas marrjes së vendimit të pezullimit të ekzekutimit të vendimit, është pezulluar edhe ecja e afatit të vonesës së debitorit për llogaritjen e kamatave të arrira, si një kërkim dytësor, i lidhur ngushtë me kërkimin kryesor të principalit të detyrimit; në përputhje me rrethanat e faktit dhe me provat e administruara interpreton nenin 481 të K.Civil, në lidhje me vonesën e debitorit.⁹

- Në funksion të arsytimit ligjor, gjyqtari interpreton dispozitat materiale në lidhje me dëmin jopasuror (*nenet 625,608 dhe 609 të K.Civil*), duke përcaktuar kushtet që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative me qëllim lindjen e përgjegjësisë për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor.¹⁰

- Në një rast tjetër, (vërtetim urdhër mbrojtje) gjyqtari interpreton dispozitat materiale të ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” në lidhje qëllimin e ligjit (*neni 1*); në lidhje me formën e kërkesëpadisë, domosdoshmërinë e përcaktimit të palëve ndërgjyqëse, si dhe nënshkrimin e padisë nga paditësja (*neni 14*); në lidhje me përfshirjen në urdhrin e mbrojtjes të personave të tjerë që do të mbrohen për shkak të lidhjes familjare që kanë me personin e dhunuar (*neni 17*).¹¹

(ii) Në vendimet penale: Në vendimet penale nuk konstatohet që të jetë bërë ndonjë interpretim teorik i normës relevante penale në lidhje me veprat penale përkatëse që i atribuohen të pandehurve, (*p.sh neni 283/2, neni 150, neni 236/2 apo neni 237 të K.Penal*), kjo për shkak se cilësimi i faktit juridik dhe përgjegjësia penale e autorit në lidhje me kryerjen e këtyre veprave penale nuk është bërë objekt kundërshtimi dhe ankimi në apel.

- Evidentohet interpretimi i dispozitave të pjesës së përgjithshme të Kodit Penal, p.sh në lidhje me individualizimin e dënimit (*nenet 47 dhe 59 të K.Penal*), në të gjitha ato raste kur shkak i ankimit ka të bëjë pikërisht me masën e dënimit, ose me aplikimin apo jo të alternativave të dënimit.¹²

Në lidhje me interpretimin e dispozitave procedurale evidentohet se gjyqtari i jep rëndësinë e duhur interpretimit të normave procedurale, kryesisht në lidhje me:

- llojin e gjykimit të aplikuar (gjykim i zakonshëm apo i shkurtuar), ku në çdo rast referohet neni 403 i K.Pr.Penale dhe jepet kuptimi i tij, si dhe kushtet për pranimin ose jo të kërkesës për procedim me këtë lloj gjykimi, duke referuar në mbështetje të

⁸ Vendimi nr. 20-2015-811/482, datë 07.09.2015;

⁹ Vendimi nr. 20-2014-887/479, datë 13.11.2014;

¹⁰ Vendimi nr. 20-2015-811/482, datë 07.09.2015;

¹¹ Vendimi nr. 20-2014-563/322, datë 15.07.2014;

¹² Vendimi nr. 20-2015-881/246, datë 23.09.2015 dhe vendimi nr. 20-2015-201/65, datë 06.03.2015;

interpretimit të ligjit procedural edhe qëndrimin e Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në vendimin Unifikues nr. 2, datë 29.01.2003;¹³

- interpreton dispozitën procedurale të pushimit të procedimit penal (*neni 329/1 të K.Pr.Penale*) në funksion të zgjidhjes së çështjes, duke përcaktuar se vetëm në rastet kur ankimi kundër vendimit të pushimit të hetimeve bëhet nga i dëmtuari nga vepra penale, gjykata në rastet se e çmon të bazuar këtë ankim, duhet të vendosë vazhdimin e hetimeve;¹⁴
- interpreton në përputhje edhe me kërkimet e palëve (*mbi kërkesën e organit të akuzës*) në lidhje me kërkesën për vleftësimin e arrestit në flagrancë (*nenet 251 dhe 252 të K.Pr.Penale*), masën e përshtatshme që duhet të vendoset ndaj personit nën hetim, të dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 284/1 i K.Penal;¹⁵
- interpreton dispozitat procedurale penale (*nenet 149, 152 dhe 226 të K.Pr.Penale*) në raport me provat e paraqitura nga organi i akuzës për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 i K.Penal, duke konkluduar se nuk provohet që i pandehuri të ketë kryer veprën penale, si bashkëpunëtor;¹⁶
- interpreton nenin 451/a të K.Pr.Civile në lidhje me vendimmarrjen në apel, duke konkluduar se ndodhemi para rastit të një padie që nuk mund të ngrihet, prandaj vendimi duhet të priset dhe çështja duhet të pushohet. Gjyqtari argumenton lidhur me kërkimin e palës për përjashtimin e provave të “pavërteta”, duke interpretuar për këtë qëllim dispozitën procedurale përkatëse (*nenin 280 të K.Pr.Civile*).¹⁷

Në lidhje me aftësinë e gjyqtarit për të përdorur jurisprudencën relevante. Evidentohet se se gjyqtari ka identifikuar dhe përdorur jurisprudencën relevante në mbështetje të argumenteve për interpretimin e ligjit dhe zbatimin e tij, në shumicën e vendimeve të analizuar. Konkretisht, në lidhje me: (i) me dyshimin e arsyeshëm, është referuar dhe analizuar, së bashku me bazën ligjore procedurale, Vendimi Unifikues i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë nr. 7, datë 14.10.2011; (ii) në lidhje me mungesën e interesit të ligjshëm të paditësit në ngritjen e padisë objekt gjykimi, gjyqtari është referuar në vendimin unifikues nr. 5, datë 30.10.2012, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, vendimin nr. 28, datë 12.11.2008 dhe vendimin nr.27, datë 26.05.2010 të Gjykatës Kushtetuese; (iii) referon vendimin Unifikues nr. 12, datë 14.09.2007 të Gjykatës së Lartë lidhur me dëmshpërblimin e dëmit jopasuror.

Nga ana tjetër, nuk identifikohet referimi në jurisprudencën e gjykatave ndërkombëtare, si ajo e GJEDNJ-së, apo në legjislacionin e vendeve të tjera, por në vendimin nr. 20-2015-337/200, datë 10.04.2015, citohen Nenet 8 dhe 10 të Konventës Europiane për Mbrojtjen

¹³ Vendimi nr. 20-2016-47/06, datë 22.01.2016, vendimi nr. 20-2015-881/246, datë 23.09.2015 dhe vendimi nr. 20-2015-201/65, datë 06.03.2015;

¹⁴ Vendimi nr. 20-2014-409/119, datë 03.06.2014;

¹⁵ Vendimi nr. 20-2015-899/105, datë 28.09.2015;

¹⁶ Vendimi nr. 20-2015-201/65, datë 06.03.2015;

¹⁷ Vendimi nr. 20-2015-899/105, datë 28.09.2015;

të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, në funksion të së drejtës për jetë private dhe lirisë së shprehjes.

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës, në çdo rast janë respektuar me korrektësi aspektet e parimit të procesit të rregullt ligjor, duke referuar dhe interpretuar në disa raste, edhe aspekte të veçanta të këtij parimi të tilla si: parimi “gjë e gjykuar”, parimi i sigurisë juridike, parimi procedural i disponibilitetit të palës paditëse në ndërtimin e ndërgjyqësisë, parimi i dhënies së drejtësisë sipas bindjes së brendshme.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsyetimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën gjyqësore të Gjykatës së Lartë, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekt i rivlerësimit Enton Dhimitri ka aftësi në arsyetim ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuar prej tij, janë të qarta dhe të kuptueshme. Ai respekton rregullat e drejtshkrimit dhe përdor të gjitha karakteret e gjuhës shqipe, në funksion të qartësisë së arsyetimit të vendimit gjyqësor*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit.

Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet zbatimi i saktë i rregullave gramatikore dhe atyre të sintaksës. Evidentohet në mënyrë të veçantë në të gjitha vendimet gjyqësore përdorimi i të gjitha shkronjave të alfabetit shqip (ë dhe ç).

Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh. në ligjet e posaçme të përdorura nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm, apo në aktet e ekspertimit të përdorur nga ekspertët me njohuri të posaçme, të ndryshme nga aktet juridike.

Në përdorimin e instituteve apo parimeve, rezulton përdorimi i termave latinë, por duke sqaruar kuptimin e tyre paraprakisht, si faktet që kanë ndodhur – *res gestae*, faktet që tregohen – *hystoria rerum gestarum*.

Në arsyetimin e vendimeve evidentohet përdorimi i fjalive me gjatësi normale, të ndërthurura dhe të kuptueshme. Fjalitë janë rrjedhë logjike e njëra tjetrës dhe paragrafët e arsyetimit të vendimit, gjithashtu. Nuk rezultojnë të jenë përdorur terma apo fjalë që krijojnë paqartësi në lidhje me kuptimin e tyre, apo të kontekstit në të cilin përdoren. Vendimi është i organizuar me paragrafë, duke kaluar mendimin nga një paragraf, në paragrafin tjetër.

Në tërësi, referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, evidentohet se gjyqtari ka aftësi të lartë të arsyetimit ligjor, në drejtim të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Struktura është e qëndrueshme, e mirëorganizuar dhe e standardizuar. Përmbajtja e vendimit është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve”*.

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtari në hartimin e vendimeve gjyqësore ndjek një strukturë të qartë, të qëndrueshme, dhe të mirëorganizuar, në përmbajtje të së cilës gjyqtari i përmbahet si prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjithashtu, konstatohet se gjyqtari ka një metodologji të qartë për hartimin e pjesëve përbërëse të vendimit, ku në mënyrë të posaçme konstatohet se ai i kushton një rëndësi të veçantë pjesës përshkruese-arsyetuese, duke e ndarë pothuajse në të gjithë vendimet në tre nënndarje të tjera, në funksion të orientimit të lexuesit dhe të kuptueshmërisë së përmbajtjes së tij.

Konkretisht, konstatohet se: Vendimi gjyqësor përmban pjesën hyrëse, pjesën përshkruese-arsyetuese, si dhe dispozitivin. *Në pjesën hyrëse* gjejnë pasqyrim të dhënat e regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet e subjekteve të pranishme në ankim dhe në proces. *Pjesa përshkruese-arsyetuese* është e ndarë në disa nënpjesë (*në fillim të pjesës përshkruese-arsyetuese pasqyrohet ndarja e titulluar “Nga shqyrtimi gjyqësor në shkallë të parë”*) në të cilën: i) gjyqtari fillimisht ndalet në pasqyrimin e fakteve dhe rrethanave të çështjes; ii) Pretendimet apo prapësimet e palëve ndërgjyqëse; iii) Provat e shqyrtuara nga gjykata e shkallës së parë. Në rastet kur kanë qenë të nevojshme përsëritja e hetimit gjyqësor apo marrja e provave të reja, provat e marra gjatë gjykimit në shkallë të dytë dhe vlerësimi i këtyre provave në raport me mënyrën e zgjidhjes së çështjes gjejnë pasqyrim në pjesën arsyetuese; iv) Interpretimi i ligjit dhe mënyra e analizimit të provave nga gjykata e shkallës së parë në funksion të zgjidhjes së çështjes; v) Përmbledhja e çështjeve të faktit dhe të ligjit që pasqyrohen në ankimin objekt shqyrtimi; *Në pjesën e dispozitivit* gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 466 të K.Pr.Civile apo nenit 428 të K.Pr.Penale, disponimi lidhur me të drejtën e ushtrimit të rekursit, afati i ushtrimit të kësaj të drejte, si dhe data e shpalljes së vendimit.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Gjyqtari i kushton vëmendje mënyrës së zgjidhjes së çështjes nga gjykata më e ulët, argumenton kur zgjidhja e dhënë prej saj është dhe kur është e gabuar, si dhe jep përgjigje për pretendimet e parashtruara në ankimin ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Në arsyetimin e vendimit nuk mungojnë kur është rasti të zbatohen drejtpërdrejtë dispozitat e Kushtetutës, të KEDNJ-së, si dhe rrëfimin në praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtari. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushton rëndësi analizës së normës ligjore. Niveli i arsyetimit të vendimeve të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor”.

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin civil apo penal, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t’u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material, civil apo penal. Evidentohet kujdesi i gjyqtarit në arsyetim për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtari në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me

zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile apo të çështjes penale, gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile dhe lidhjes shkakësore të faktit penal, duke qenë se rëndësia e lidhjes shkakësore qëndron në kuptimin ndërmjet shkakut dhe pasojës së ardhur nga kryerja e veprës penale. Konkretisht, në lidhje me sa më sipër, konstatohet se:

Në vendimet civile: - Gjyqtari evidenton në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar dhe analizën e koncepteve ligjore në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Konkretisht, pas interpretimit të dispozitave procedurale (neneve 150, 297, 479 dhe 615 i K.Pr.Civile) në lidhje me “pezullimin e ekzekutimit të vendimit” dhe “pezullimin e gjykimit”, referuar pretendimeve të palës ankuese, gjyqtari konkludon ndryshe nga gjykimi në shkallë të parë, duke argumentuar se me pezullimin e ekzekutimit të një vendimi gjyqësor pezullohet çdo lloj afati apo veprim i mëtejshëm mbi këtë vendim, duke përfshirë edhe ecjen e interesave mbi detyrimin e përcaktuar apo ecjen e afatit të vonesës për përlllogaritjen e kamatave të arrira, sipas kuptimit të dhënë nga neni 450 i K.Civil.¹⁸

- Referuar kërkit të palës paditëse për detyrimin e të paditurës që ta njohin si trashëgimtare në pasurinë trashëgimore, gjyqtari ndalet në pavlefshmërinë e testamentit dhe në mbështetje edhe të normave relevante (nenet 379, 407 dhe 412 të K.Civil) të konkludojë se testamenti është absolutisht i pavlefshëm kur disponimi me testament i trashëgimlënësit, i përjashton nga trashëgimia ligjore trashëgimtarët e tij të paaftë për punë. Për shkak të pavlefshmërisë absolute të këtij veprimi juridik, rrjedh pasoja juridike e kërkit të paditëses, për rregullimin e pasojave të pavlefshmërisë.¹⁹

- Referuar pretendimeve të ngritur nga ana e palës së paditur në ankim, gjyqtari, në interpretim të neneve 625, 608, 609 dhe 647/a të K.Civil, si dhe konkluzioneve të Vendimit Unifikues nr.12, datë 14.09.2007, ka konkluduar në një qëndrim ndryshe nga vendimi i shkallës së parë. Konstatohet se niveli i arsyetimit dhe përmbajtja e vendimit janë gjithëpërfshirës, duke u dhënë përgjigje të gjitha pretendimeve të palëve në ankim dhe me rrjedhë logjike drejt konkluzionin e arritur.²⁰

Në vendimet penale: gjyqtari i kushton një rëndësi të veçantë analizimit të katër elementëve të veprës penale për të cilën akuzohet i pandehuri, duke u ndalur në mënyrë më specifike tek ana objektive e veprës penale. Gjatë analizës së veprës penale që i atribuohet të pandehurit, gjyqtari identifikon lidhjen shkak-pasojë të veprimeve apo mosveprimeve të të pandehurit, në ardhjen e pasojës së dëmshme.

¹⁸ Vendimi nr. 20-2014-887/479, datë 13.11.2014;

¹⁹ Vendimi nr. 20-2015-811/482, datë 07.09.2015;

²⁰ Vendimi nr. 20-2015-337/200, datë 10.04.2015;

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe i jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërkimeve të palëve ndërgjyqëse që lidhen në mënyrë konkrete edhe me shkaqet e ankimit të palëve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarit”

KRITERI AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARIT

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarit në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtari përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Ndër këto 5 dosje, në 3 raste janë respektuar afatet ligjore apo standarde të gjykimit (shih dosjet 12 dhe 5), ndërsa në 2 raste të tjera, afati standard 6 mujor është tejkaluar”*.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në Kodin e Procedurës Penale nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve penale të themelit. Po kështu, edhe për çështjet civile, në përgjithësi, nuk parashikohet afat ligjor për përfundimin e tyre.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, referuar kategorisë së çështjeve, rezulton se vetëm për 1 (një) prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në Apel.²¹

Konkretisht, për kërkesën penale me objekt “vleftësim arresti dhe caktimin e masës së sigurimit”, neni 249 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se kërkesa shqyrtohet brenda 10 ditëve nga marrja në dorëzim e akteve. Në rastin konkret (dosja 2), kërkesa është regjistruar në Gjykatën e Apelit Gjirokastër në datën 22.09.2015, dhe ka përfunduar në datën 28.09.2015 (6 ditë), duke respektuar afatin ligjor dhjetë ditor, të përcaktuar në nenin 249, pika 5, të K.Pr.Penale.

Për sa më sipër, duke iu referuar çështjes për të cilën ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, rezulton se ky afat është respektuar. Për pasojë, pavarësisht se të dhënat statistikore të administruara në dosje nuk japin informacion për kohëzgjatjen e të gjitha çështjeve për të cilat ligji parashikon afat gjykimi, duke iu referuar çështjes së analizuar më sipër, aftësia e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues pikëzohet në nivelin maksimal.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka treguar kujdes të posaçëm për zhvillimin e gjykimit brenda afateve ligjore, në çështjen e analizuar për të cilën ligji ka parashikuar afat shqyrtimi, duke treguar aftësi shumë të mira në respektimin e tyre.

²¹ Afati ligjor 60 ditë i parashikuar për përfundimin e çështjeve në gjykimin në Apel në nenin 609 të K.Pr.Civile ka hyrë në fuqi në Korrik 2016, po kështu edhe afati 15 ditë i parashikuar në nenin 21 të ligjit 9669 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, është shtuar me ndryshimet e ligjit në vitin 2018, pra të dyja këto afate ligjore gjykimi nuk i përkasin periudhës objekt vlerësimi.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, në kushtet kur nuk ka asnjë çështje të shqyrtuar jashtë afatit ligjor, gjyqtari pikëzohet me 15 pikë.

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Enton Dhimitri ka qenë në intervale kohore nga 6 ditë (shih dosjen 2) deri në 11 muaj e 26 ditë (shih dosjen 3). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 11 muaj e 26 ditë ka qenë civile themeli komplekse, e kthyer për rigjykim me detyra konkrete nga Gjykata e Lartë, tek e cila kanë marrë pjesë 2 gjyqtarë me delegim nga një gjykatë tjetër, por që është zgjidhur me vendim jopërfundimtar (shih dosjen 3). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 35 ditë (shih dosjen 1), 6 muaj e 19 ditë (shih dosjen 4) dhe 1 muaj e 23 ditë (shih dosjen 5). Ndër këto 5 dosje, në raste janë respektuar afatet ligjore apo standarde të gjykimit (shih dosjet 1, 2 dhe 5), ndërsa në 2 raste të tjera, afati standard 6 mujor është tejkaluar (shih dosjet 3 dhe 4). Në 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit. Nga analiza e tre dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 2 muaj e 9 ditë (shih dokumentin nr. 1), 5 muaj (shih dokumentin nr.2) dhe 3 muaj e 3 ditë (shih dokumentin nr. 3). Në të treja këto raste është respektuar afati i standardi i gjykimit”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, evidentohet se për çështjet e vëzhguara, gjykimi ka zgjatur brenda standardeve minimale kohore, sipas Vendimit nr.261/2 të KLD, dhe duke i ndarë sipas kategorisë së çështjeve rezultojnë se:

Kërkesa penale:

- Dosja 1 – *(është caktuar me short në datën 28.04.2014 dhe ka përfunduar në datën 03.06.2014)* Gjykimi ka zgjatur 35 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet e kërkesave administrative-penale (jo më tej se 2 muaj);

Çështje penale:

- Dosja 7 - rezulton se është regjistruar në datën 03.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 09.09.2014. Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 6 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;
- Dosja 9– *(është caktuar me short në datë 01.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 23.09.2015)* Gjykimi ka zgjatur 22 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).
- Dosja 11- *(është caktuar me short në datë 07.09.2015 dhe ka përfunduar në datën 22.01.2016)* Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 15 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).
- Vendimi 3 -*(është regjistruar në datë 03.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 06.03.2015)* Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 3 ditë, brenda standardit minimal kohor për gjykimet penale (për veprat penale të kategorisë krime).

Çështje civile:

- Dosja 3 – rezulton se është regjistruar në datën 18.12.2014 dhe ka përfunduar në datën 18.12.2015. Gjykimi ka zgjatur 11 muaj e 26 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim dhe referuar datës së seancës së parë gjyqësore, datë 30.01.2015, do të konstatohej se kjo çështje ka përfunduar brenda një afati prej 10 muaj dhe 18 ditë, pra tej standardit minimal kohor për gjykimin prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;
- Dosja 4 – rezulton se është regjistruar në datën 08.09.2014 dhe ka përfunduar në datën 03.04.2015. Gjykimi ka zgjatur 6 muaj e 19 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim dhe referuar datës së seancës së parë gjyqësore, datë 03.10.2014, do të konstatohej se kjo çështje ka përfunduar për 6 muaj, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;
- Dosja 6 - rezulton se është regjistruar në datën 20.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 15.10.2014. Gjykimi ka zgjatur 3 muaj e 25 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim dhe referuar datës së seancës së parë gjyqësore, datë 23.07.2014, do të konstatohej se kjo çështje ka përfunduar për 2 muaj 22 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;
- Dosja 8 - rezulton se është regjistruar në datën 20.04.2015 dhe ka përfunduar në datën 07.09.2015. Gjykimi ka zgjatur 4 muaj e 18 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim dhe referuar datës së seancës së parë gjyqësore, datë

07.05.2015, do të konstatohej se kjo çështje ka përfunduar për 4 muaj, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;

- Dosja 10 - rezulton se është regjistruar në datën 17.10.2014, dhe me shortin e datës 24.11.2014 i është caktuar për gjykim gjyqtarit, duke përfunduar gjykimi në datën 07.09.2015. Gjykimi ka zgjatur 9 muaj e 14 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim dhe referuar datës së seancës së parë gjyqësore, datë 13.01.2015, do të konstatohej se kjo çështje ka përfunduar për 7 muaj e 25 ditë, pra tej standardit minimal kohor prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;²²
- Vendimi 1 *-(është regjistruar në datë 04.09.2014 dhe ka përfunduar në datë 13.11.2014)*. Gjykimi ka zgjatur 2 muaj e 9 ditë, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;
- Vendimi 2 *-(është regjistruar në datë 10.11.2014 dhe ka përfunduar në datë 10.04.2015)*. Gjykimi ka zgjatur 5 muaj, brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së.

Çështje familjare:

- Dosja 5 - rezulton se është regjistruar në datën 19.05.2014 dhe ka përfunduar në datën 15.07.2014. Gjykimi ka zgjatur 1 muaj e 23 ditë. Duke u nisur nga data e nxjerrjes së çështjes në gjykim dhe referuar datës së seancës së parë gjyqësore, datë 24.06.2014, do të konstatohej se kjo çështje ka përfunduar për 21 ditë, pra brenda standardit minimal kohor prej 6 muaj, referuar vendimit 261/2 të ish KLD-së;

Referuar përlllogaritjes së afatit të gjykimit për të gjitha çështjet për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor dhe për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, rezulton se kohëzgjatja e tyre ka qenë nga 22 ditë (dosja 9 – kohëzgjatja më e vogël), deri në 10 muaj e 18 ditë (dosja 3 – kohëzgjatja më e madhe). Rezulton që 11 nga 13 çështjet e vëzhguara të jenë gjykuar brenda standardit minimal kohor në fuqi.

Duke iu referuar raportit të numrit të çështjeve për të cilat gjykimi ka përfunduar tej standardit minimal kohor, në raport me numrin e çështjeve të analizuara (2/13) rezulton se çështjet e shqyrtuara në tejkalim të standardit minimal kohor, përbëjnë rreth 15% të tyre. Pavarësisht mënyrës së llogaritjes, duke analizuar shkaqet që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit tej standardit dhe veprimet procedurale të kryera nga gjyqtari për të menaxhuar ecurinë e çështjeve, vlerësohet se vonesat në shqyrtim nuk kanë ndodhur për shkak të mosmarrjes së masave nga ana e gjyqtarit.

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit dhe analizës së mësipërme lidhur me afatin e gjykimit të çështjeve për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, raportit të këtyre çështjeve me numrin total të çështjeve që rezulton në masën 15%, si dhe shkaqeve që ndikojnë në kohëzgjatjen e gjykimit sipas burimeve të vlerësimit, shkaqe të cilat nuk rezultojnë në asnjë rast të jenë përgjegjësi e gjyqtarit, por rrjedhojë e rrethanave objektive që lidhen me

²² Çështje kjo e referuar edhe në relacionin nr. 1192/1 Prot., datë 23.06.2016 të ish-Inspektoratit të KLD-së.

ecurinë e procesit, respektimin e të drejtave të palëve, njoftimin e tyre etj., ky tregues pikëzohet në nivelin maksimal.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i standardeve minimale kohore” gjyqtari vlerësohet në nivelin “Mbi 0 - 10%”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve nga gjyqtari Enton Dhimitri ka qenë në intervale kohore nga 6 ditë (shih dosjen 2) deri në 11 muaj e 26 ditë (shih dosjen 3). Çështja, që ka patur kohëzgjatjen më të lartë të gjykimit 11 muaj e 26 ditë ka qenë civile themeli komplekse, e kthyer për rigjykim me detyra konkrete nga Gjykata e Lartë, tek e cila kanë marrë pjesë 2 gjyqtarë me delegim nga një gjykatë tjetër, por që është zgjidhur me vendim jopërfundimtar (shih dosjen 3). Në tre dosjet e tjera, kohëzgjatja e gjykimit ka qenë 35 ditë (shih dosjen 1), 6 muaj e 19 ditë (shih dosjen 4) dhe 1 muaj e 23 ditë (shih dosjen 5). Ndër këto 5 dosje, në raste janë respektuar afatet ligjore apo standarde të gjykimit (shih dosjet 1, 2 dhe 5), ndërsa në 2 raste të tjera, afati standard 6 mujor është tejkaluar (shih dosjet 3 dhe 4). Në 3 dokumentet e paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit është analizuar kohëzgjatja, sipas attributeve të shënuara në hyrje të tekstit të vetë vendimit. Kjo e dhënë nuk tregon saktësisht datën e marrjes së akteve me short nga gjyqtari, por i referohet datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Apelit. Nga analiza e tre dokumenteve është konstatuar se kohëzgjatja e gjykimeve ka qenë 2 muaj e 9 ditë (shih dokumentin nr. 1), 5 muaj (shih dokumentin nr.2) dhe 3 muaj e 3 ditë (shih dokumentin nr. 3). Në të treja këto raste është respektuar afati i standardi i gjykimit”.

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve. Për rrjedhojë, vlerësimi

lidhur me këtë tregues, do të bëhet duke iu referuar 10 çështjeve të përzgjedhura me short, 3 vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtari, për të cilat zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.²³

Duke krahasuar kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, në raport me standardin minimal kohor për çdo kategori (*13 çështjet e marra në analizë 4 janë çështje penale themeli, 7 çështje civile themeli 1 çështje familjare dhe 1 çështje penale - administrative*), rezultoi se:

- (i) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 4 (katër) çështjet në kategorinë e çështjeve “penale krime”, rezultoi të jetë 76 ditë ose 2 muaj e 2 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale krime në Gjykatën e Apelit.²⁴
- (ii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “familjare”, rezultoi të jetë 21 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Apelit.²⁵
- (iii) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 7 (shtatë) çështje në kategorinë e çështjeve “civile të përgjithshme”, rezultoi të jetë 165 ditë, rreth 5 muaj e 15 ditë, pra e shkurtër me standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve civile të themelit në Gjykatën e Apelit.
- (iv) Mesatarja e kohëzgjatjes së gjykimit për 1 (një) çështje në kategorinë e çështjeve “penale administrative”, rezultoi të jetë rreth 1 muaj e 5 ditë, pra më e shkurtër se standardi minimal kohor për gjykimin e çështjeve penale administrative në Gjykatën e Apelit.²⁶

Pra, kohëzgjatja mesatare e çështjeve të vëzhguara, është më e shkurtër se standardi minimal kohor për të gjitha çështjet e kësaj kategorie.

KONKLUZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezultoi se standardi minimal kohor në fuqi është respektuar për të gjitha kategoritë e çështjeve të analizuara.

²³ Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se : “*Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi*”.

²⁴ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*g. Gjykimet penale në gjykatën e apelit, jo më tej se 2 muaj kur procedohet për kundërvajtje penale, jo më tej se 6 muaj kur procedohet për krime që dënohen në maksimum deri në 10 vjet burgim dhe jo më tej se 9 muaj kur procedohet për krime që dënohen në minimum jo më pak se 10 vjet burgim ose me burgim të përjetshëm*”.

²⁵ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*h. Gjykimet civile në gjykatën e apelit, jo më tej se 6 muaj*”.

²⁶ Në pikën 5 të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: “*k. Gjykimi i çështjeve të karakterit administrativo-penal dhe i çështjeve civile pa palë kundërshtarë në gjykatën e apelit, jo më tej respektivisht se 2 muaj dhe 4 muaj*”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” është “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha e kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “...Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 96.4%...”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:

Në total, në gjithë periudhën e vlerësimit gjyqtarit Enton Dhimitri: në vitin 2014 i janë caktuar 62 çështje pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë;²⁷ në vitin 2014 i janë caktuar për gjykim 210 çështje; në vitin 2015 i janë caktuar për gjykim 318 çështje dhe në vitin 2016 i janë caktuar për gjykim 230 çështje.²⁸ Për periudhën 08.10.2013-12.03.2014 ka përfunduar gjykimin pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë për 62 çështje. Rezulton se nga data 13.03.2014-31.12.2014 ka përfunduar gjykimin pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë për 147 çështje, për vitin 2015 ka përfunduar 318 çështje dhe për vitin 2016 ka përfunduar 235 çështje.

Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë konstatohet se për periudhën e vlerësimit 2013-2016 gjyqtari Enton Dhimitri ka përfunduar 654 çështje, nga të cilat 257 çështje penale dhe 397 çështje civile.

Duke qenë se ka mungesë të dhënash në tabelat me të dhëna statistikore për çështjet e caktuara gjatë periudhës së vlerësimit, mbetet e pamundur përlllogaritja e rendimentit sipas të dhënave statistikore që administrohen në dosje dhe për rrjedhojë, do të merret i mirëqenë rendimenti 96.4% i përcaktuar në faqen 23 të Raportit.

²⁷ Sipas vërtetimit nr. 45 Port., datë 20.01.2017 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, të administruar në faqen 45 të dosjes së rivlerësimit.

²⁸ Sipas vërtetimit nr. 65 Port., datë 19.01.2017 të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, të administruar në faqen 44 të dosjes së rivlerësimit.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rendimenti i gjyqtarit për periudhën e plotë të vlerësimit rezulton në masën 96.4%.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore” është “Mbi 93-99%”, duke e pikëzuar me 8 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);
- Informacioni i përcjellë nga gjykatat²⁹ lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se “Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtari Enton Dhimitri i ka kushtuar rëndësi arsyetimit në kohën e duhur vendimeve gjyqësore, duke respektuar në çdo rast afatet ligjore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer për 2 ditë nga shpallja (shih dosjet 1), për 4 ditë nga shpallja (shih dosjen 2) për 3 ditë nga shpallja (shih dosjen 3), për 7 ditë nga shpallja (shih dosjen 4) dhe për 2 ditë nga shpallja (shih dosjen 5)”.

²⁹ Informacioni i dërguar nga Gjykata e Apelit Gjirokastër nëpërmjet postës elektronike në datën 01.04.2021.

Në Kodin e Procedurës Penale në fuqi para ndryshimeve me Ligjin 35/2017, nuk ishte parashikuar sikundër sot, afat procedural për dorëzimin e vendimit të arsyetuar. Në praktikën gjyqësore kjo kohë gjithsesi nuk mund të ishte më e gjatë sesa afati i ankimit 30 (tridhjetë) ditor, sipas parashikimeve të nenit 435 pika 1 të K.Pr.Penale, në fuqi para ndryshimeve me ligjin nr. 35/2017, për shkak se e drejta e palëve për ushtrimin e rekursit ndaj vendimit penal të gjykatës së apelit, kur palët ishin prezent, fillonte nga e nesërmja e shpalljes së vendimit. Mbështetur në të njëjtin arsyetim, edhe për vendimet civile, K.Pr.Civile (para nëntorit 2017) nuk parashikonte afat procedural, por gjithsesi ky afat nuk mund të ishte më i gjatë se afati për ushtrimin e të drejtës së rekursit sipas parashikimeve të nenit 443 paragrafi i dytë dhe nenit 476 të K.Pr.Civile. Në këto kushte, në llogaritjen e afatit të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, mbahet parasysh në rastin konkret, afati 30 ditor i rekursit ndaj vendimit penal dhe civil të gjykatës së apelit.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 20-2014-409/119 datë 03.06.2014, është dorëzuar në datën 05.06.2014 - (2 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 28.09.2015, datë 28.09.2015 është dorëzuar në datën 02.10.2015 - (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 20-2015-1250/727, datë 18.12.2015 është dorëzuar në datën 21.12.2015 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.³⁰
- Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 20-2015-311/184, datë 03.04.2015 është dorëzuar në datën 10.04.2015 - (7 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 20-2014-563/322, datë 15.07.2014 është dorëzuar në datën 18.07.2014 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.

Sipas informacioneve të dërguara nga Gjykata e Apelit Gjirokastrë nëpërmjet postës elektronike të datës 01.04.2021, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 04.09.2020, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 20-2014-771/426, datë 15.10.2014, është dorëzuar në datën 27.10.2014 - (12 ditë), tej afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- Dosja 7, që i përket vendimit me nr.20-2014-637/176, datë 09.09.2014, është dorëzuar në datën 12.09.2014 - (3 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

³⁰ Në kodin e procedurës civile nuk rezulton që të jetë parashikuar një afat tjetër veç atij të përgjithshëm për arsyetimin e vendimeve të parashikuar në nenin 308 të K.Pr.Civile edhe për gjykimin në Apel.

- Dosja 8, që i përket vendimit me nr.20-2015-811/482, datë 07.09.2015, është dorëzuar në datën 30.09.2015 - (23 ditë), tej afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- Dosja 9, që i përket vendimit me nr.20-2015-881/246, datë 23.09.2015, është dorëzuar në datën 28.09.2015 - (5 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.
- Dosja 10, që i përket vendimit me nr.20-2016-151/99, datë 22.02.2016, është dorëzuar në datën 03.03.2016- (9 ditë), brenda afatit 10 ditor të përcaktuar në nenin 308/2 të K.Pr.Civile.
- Dosja 11, që i përket vendimit me nr.20-2016-47/06, datë 22.01.2016 është dorëzuar në datën 26.01.2016- (4 ditë), brenda afatit 10 ditor, sipas nenit 415 të K.Pr.Penale në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar edhe interpretimit të sipërcituar.

Duke iu referuar kategorive të çështjeve objekt shqyrtimi, rezulton se koha mesatare e arsyetimit të vendimit për kategorinë “*civile të përgjithshme*” është 10.8 ditë; për kategorinë “*familjare me palë kundërshtarë*” është 3 ditë; për kategorinë “*penale krime*” është 4 ditë; për kategorinë “*kërkesa penale të hetimit paraprak*” është 4 ditë dhe për kategorinë “*kërkesa administrative-penal*” është 2 ditë.

KONKLUZIONI

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, koha mesatare e arsyetimit të vendimit përfundimtar rezulton “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” është “Më e shkurtër ose e barabartë me afatin procedural për të gjitha kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;

- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit Enton Dhimitri ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore. Dosjet e vëzhguara janë vënë në lëvizje pa vonesa prej tij. Në 5 çështjet e vëzhguara, gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë (shih dosjet 1 dhe 2), me 11 seanca (shih dosjen 3), me 6 seanca (shih dosje 4) dhe me 2 seanca (shih dosjen 5). Këto të dhëna reagojnë se janë vëzhguara 22 seanca gjyqësore, nga të cilat 9 seanca kanë qenë produktive. Pengesë në 13 seanca gjyqësore joproduktive janë bërë mosformim i trupit gjykues (6 seanca) dhe njoftimi apo mosparaqitja e palëve (6 seanca) dhe paraqitja e mbrojtëses e papërgatitur me aktet (1 seancë). Nuk ka patur asnjë seancë të dështuar për shkak të vetë gjyqtarit Enton Dhimitri. Seancat e vëzhguara janë çelur me vonesë në orar nga planifikimi, por ora e fillimit të tyre është dokumentuar gjithmonë e saktë. Vonesa në fillimin e seancave nuk ka penguar ecurinë e gjykimit. Një tipar i mirë i punës së tej respektimi i solemniteti, duke zhvilluar gjykimin gjithmonë në sallë dhe duke regjistruar audio seancat gjyqësore”.*

Nga 11 çështjet e përzgjedhura për vlerësim, lidhur me numrin e seancave gjyqësore të gjitha çështjet vlerësohen si çështje me palë kundërshtare për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarit (me përjashtim të dosjes nr. 1, që i takon kategorisë kërkesa penale në fazën e hetimeve paraprake dhe dosjes me nr. 2, që i takon kategorisë së kërkesave administrative-penal).

❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, administruar në dosjen e rivlerësimit konstatohet se:

- Dosja 3 – që i përket çështjes civile, me nr. 132/688 (21298-00530-20-2014) regjistri, datë regjistrimi 18.12.2014, me objekt “Kallëzimi i një punimi të ri”, përfunduar me vendimin nr.20-2015-1250/727, datë 18.12.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, rezulton që për përfundimin e çështjes janë zhvilluar 11 (njëmbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 8 seanca kanë rezultuar joproduktive, 5 prej të cilave nuk janë zhvilluar për mosformim të trupit gjykues, ndërsa 3 seanca e tjera janë shtyrë për shkak të mosparaqitjes së palëve. Nuk rezulton në asnjë rast që gjyqtari të jetë bërë shkak për shtyrjen e seancës gjyqësore.
- Dosja 4 – që i përket çështjes civile, me nr. 33/505 (21286-000336-20-2014) regjistri, datë regjistrimi 08.09.2014, përfunduar me vendimin nr.20-2015-311/184, datë 03.04.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastër, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 6 (gjashtë) seanca gjyqësore, nga të cilat 4 seanca kanë qenë joproduktive, duke u shtyrë 2 për shkak të njoftimit të palëve, 1 për shkak të paraqitjes në gjykim të mbrojtësit të papërgatitur me provat shkresore dhe 1 për mosformim të trupit gjykues (KLD ende nuk ishte shprehur për kërkesën për delegim gjyqtari).

- Dosja 5 – që i përket çështjes familjare, me nr. 353 (11232-00178-20-2014) regjistri, datë regjistrimi 19.05.2014, me objekt “Vërtetim i urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes”, përfunduar me vendimin nr.20-2014-563/322, datë 15.07.2014, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 2 (dy) seanca gjyqësore, nga të cilat 1 seancë ka qenë joproduktive, ku shkak për shtyrje është bërë mosparaqitja e palës paditëse për arsye familjare.

- ❖ Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit konstatohet se:

- Dosja 6 – që i përket çështjes civile, me nr. 398 921269-00223-20-2014) regjistri, datë regjistrimi 20.06.2014, me objekt “njohje pronar”, përfunduar me vendimin nr.20-2014-771/426, datë 15.10.2014, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat 2 seanca kanë qenë joproduktive, nga të cilat njëra është shtyrë për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesit të palas paditëse dhe tjetra për t’i lënë kohë palës për t’u njohur me aktet e dosjes.
- Dosja 7 – që i përket çështjes penale, me nr.199 (53301-00267-20-2014) regjistri, datë regjistrimi 03.07.2014, përfunduar me vendimin nr. 20-2014-637/176, datë 09.09.2014, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 8 – që i përket çështjes civile, me nr. 381 (21275-00249-20-2015) regjistri, datë regjistrimi 20.04.2015, me objekt “pavlefshmëri testamenti”, përfunduar me vendimin nr.20-2015-811/482, datë 07.09.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 5 (pesë) seanca gjyqësore, nga të cilat 4 (katër) seanca kanë qenë joproduktive, të cilat janë shtyrë për mosformim të trupit gjykues. Nuk rezulton në asnjë rast që gjyqtari të jetë bërë shkak për shtyrjen e seancës gjyqësore.
- Dosja 9 – që i përket çështjes penale, me nr. 284(58325-00322-20-2015) regjistri, datë regjistrimi 29.07.2015, përfunduar me vendimin nr. 20-2015-881/246, datë 23.09.2015, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jetë zhvilluar 1 (një) seancë gjyqësore, e cila ka rezultuar produktive, duke përfunduar me dhënien e vendimit përfundimtar.
- Dosja 10 – që i përket çështjes civile, me nr. 16/42/545 regjistri, datë regjistrimi 13.10.2014, përfunduar me vendimin nr.20-2016-151/99, datë 22.02.2016, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, rezulton që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 14 (katërbëdhjetë) seanca gjyqësore, nga të cilat 6 (gjashtë) seanca kanë qenë joproduktive dhe janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues, për shkak të mosparaqitjes së përfaqësuesve të palës paditëse apo të palës së paditur, si dhe për shkak të faktit se një nga anëtarët e trupit gjykues ka vlerësuar të japë dorëheqjen, duke pasur shkak të përligjur për të mos shqyrtuar çështjen.
- Dosja 11 – që i përket çështjes penale, me nr.04/302 (58103-00341-20-2015) regjistri, datë regjistrimi 01.09.2015, përfunduar me vendimin nr. 20-2016-47/06, datë 22.01.2016, të Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, rezulton që për përfundimin e çështjes të

jenë zhvilluar 4 (katër) seanca gjyqësore, nga të cilat 3 (tre) seanca kanë rezultuar joproduktive, duke u shtyrë për shkak të mosparaqitjes së të pandehurit, për shkak të mosparaqitjes së mbrojtësit të të pandehurit, si dhe me qëllim lënien kohë mbrojtësit për t'u njohur me aktet e dosjes.

Nga tërësia e të dhënave të mësipërme, rezulton se numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtari në 9 çështjet e vëzhguara me palë kundërshtare (penale themeli, civile themeli dhe familjare) varion nga 1, deri në 14 seanca. Numri mesatar i seancave gjyqësore, duke iu referuar çështjeve të vëzhguara, rezulton të jetë 5.3 seanca gjyqësore.

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, nga vëzhgimi i 9 dosjeve të çështjeve me palë kundërshtare, rezulton se gjyqtari ka kryer me korrektësi të gjitha veprimet procedurale për planifikimin dhe zhvillimin në kohë dhe me efektivitet të seancave gjyqësore, duke respektuar në çdo rast ligjin procedural civil dhe penal (nenin 460 të K.Pr.Civile dhe nenet 426 dhe 342/2 të K.Pr.Penale). Gjyqtari ka mbikëqyrur si duhet dërgimin pa vonesë të njoftimeve, njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që iu drejtohen, nuk konstatohet në asnjë rast mungesa e njoftimeve për palët në dosje (*me përjashtim të njoftimeve të cilat janë bërë me shpallje konform dispozitave procedurale në lidhje me njoftimet në gjykimin në Apel*) dhe në çdo rast janë marrë masa efektive për të siguruar zhvillimin e seancave gjyqësore në kohë. Në çështjet në të cilat seancat gjyqësore nuk janë çelur për shkak të mosfomimit të trupit gjykues, rezulton që seancat vijuese të jenë planifikuar në një kohë shumë të afërt dhe janë marrë masa efektive për të siguruar vijimin pa vonesa të gjykimit. Në të gjitha rastet e tjera, shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale, të tilla si: njoftimi i të pandehurve, njoftimi i mbrojtësve të të pandehurit, etj. Në çdo rast të shtyrjes së seancave për shkaqe procedurale janë respektuar afatet ligjore për caktimin e seancës vijuese, sipas parashikimeve të nenit 342/2 të K.Pr.Penale.

Referuar sa më sipër, për treguesin e “*Numrit mesatar të seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerjen e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproduktive*”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i 9 çështjeve me palë kundërshtare të përzgjedhura me short, rezulton se numri mesatar i seancave gjyqësore është 5.3 seanca. Pavarësisht numrit mesatar të seancave, gjyqtari në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproduktive, planifikimin dhe zhvillimin e seancave në kohë dhe me efektivitet, përveçse kur kjo ka qenë objektivist e pamundur.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri mesatar i seancave gjyqësore është më i lartë se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtari në shmangien e seancave joproduktive dhe administrimin e procesit në tërësi është e lartë, prandaj gjyqtari vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarit për këtë tregues, është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se: *“Gjatë gjykimit, ai identifikon veprimet procedurale që duhen kryer, merr mendimin e palëve për to, si dhe nxjerr urdhra dhe vendime të ndërmjetme të arsyetuara për realizimin e tyre. I kushton rëndësi rasteve të kthyerës për rigjykim nga Gjykata e Lartë, duke identifikuar detyrat që duhen përmbushur (shih dosjet 3 dhe 4). Distanca kohore midis seancave janë të arsyeshme dhe në raport me shkallën për të cilin seanca është shtyrë. Nuk janë konstatuar vonesa në lëshimin e akteve të njoftimit, por në njoftimin efektive të palëve ka ndikuar rigjykimi i çështjeve, ku është evidentuar se palët kanë ndërruar vendbanim. Gjyqtari Enton Dhimitri zhvillon në mënyrë korrekte procedurën e gjykimit gjatë drejtimit të procesi gjyqësor, duke ndjekur hapat që lidhen me çeljen e seancës, verifikimin e palëve me të drejtat dhe detyrimet procedurale, si dhe për prezantimin e gjykatës. Orienton drejt debatin dhe hetimin gjyqësor, marrjen e provave, kërkimet dhe prapësimet e palëve gjer në dhënien e vendimit përfundimtar”.*

Nga çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, rezulton se çështjet i përkasin kategorisë së çështjeve penale, civile të përgjithshme me palë kundërshtarë, çështje familjare me palë kundërshtarë, kërkesa në fazën e hetimit paraprak dhe kërkesa administrative-penale.

Gjyqtari ka vënë në lëvizje çështjet (konstatohet se në asnjë rast nuk është nxjerrë vendimi për caktimin e seancës) për caktimin e seancës së parë gjyqësore disa ditë pas caktimit të çështjes me short, duke iu referuar rregullave dhe gjykimit të çështjeve në Apel, konform nenit 460 të K.Pr.Civile dhe nenit 426 e vijues të K.Pr.Penale. Seancat gjyqësore të zhvilluara në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës

gjqësore, mbajtur me regjistrim audio, si dhe dokumentohen me shkrim nga sekretarja gjyqësore.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se përgjithësisht në çështjet e përzgjedhura me short, gjyqtari i ka vënë në lëvizje dosjet në kohë dhe në përputhje me kërkesat dhe afatet ligjore, duke caktuar seancën dhe duke kryer njoftimet përkatëse për palët.³¹ Gjithashtu, rezulton se të gjitha veprimet procedurale gjatë shqyrtimit gjyqësor janë të dokumentuara. Drejtimi i procesit gjyqësor ka qenë i rregullt, sipas kërkesave procedurale të parashikuara në ligji për gjykimin në apel (*neni 464 i K.Pr.Civile dhe neni 426/a i K.Pr.Penale*) kur është gjykuar si shkallë e dytë, mbi bazë ankimi. Gjatë zhvillimit të gjykimit, gjyqtari tregon kujdes të posaçëm për verifikimin e paraqitjes së palëve, mbrojtësve, relativin e akteve të njoftimit të tyre, shkaqeve të mosparaqitjes së palëve ose pjesëmarrësve, marrjen e mendimit të palëve në çdo rast lidhur me ecurinë e gjykimit, zhvillimin e gjykimit në mungesë të të pandehurit, shpalljen e gjykatës, dëgjimin e kërkesave paraprake të palëve, shqyrtimin dhe vendimmarrjen e arsyetuar të gjykatës mbi këto kërkesa, zhvillimin e shqyrtimit gjyqësor sipas llojit të procesit të zhvilluar (*si shkallë e dytë*), dhënien e fjalës palëve mbi shkaqet e ankimit, shtyrjen e seancave gjyqësore, duke pasqyruar shkakun në çdo rast, si dhe urdhërimet për marrjen e masave për zhvillimin e seancës vijuese (*njoftimin e palëve, kryerjen e komunikimit me institucionet e tjera, etj.*). Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur përgjithësisht me vonesë, shpesh herë, pa u shoqëruar me relativin e shkakut që ka pasjellë vonesën në çeljen e seancës.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka treguar shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, evidentuar në korrektësinë e planifikimit, mbikëqyrjes, zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit penal dhe civil, në seancat gjyqësore të zhvilluara.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi :** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.*

³¹ Neni 460/2/5 i K.Pr.Civile dhe neni 426 i K.Pr.Penale

2.C. AFTËSIA E GJYQTARIT PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se *“Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet. Në 5 dosjet të vëzhguara mangësitë janë të njëjta³²: nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore. Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes, procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal”*.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, lidhur me rregullshmërinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se përgjithësisht dosjet janë renditura në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. rezulton “përgjithësisht”, pasi në dosjet me nr. 10 dhe 11 konstatohet se aktet procedurale nuk janë renditur në mënyrë logjike, sipas kategorisë (*aktet procedurale të shortit, procesverbali i seancës gjyqësore, vendimi gjyqësor përfundimtar*) dhe nuk janë renditur në rend kronologjik (*sipas datave ose momentit të paraqitjes së tyre*), brenda të njëjtës kategori aktesh.

Konkretisht, në dosjen 10, renditja e akteve në dosje fillon me njoftimet për palët (*jo sipas datave*), për të vijuar me provat e paraqitura nga palët; prapësimet e palës së paditur; kërkesat për heqje dorë nga ankimi; sërish provat e paraqitura nga palët; ankimi i palës së paditur; kërkesa për heqje dorë nga ankimi; prova; konkluzionet përfundimtare të palëve; vendimi për përjashtimin e gjyqtarit, datë 10.12.2015; vendimi për shqyrtimin e dorëheqjes; kërkesa për heqje dorë nga gjykimi; kërkesë për shtyrje të seancës, datë 18.11.2014; kërkesë për përjashtim të gjyqtarit, datë 03.10.2014; prova të paraqitura nga palët; konkluzionet përfundimtare të njërit prej të paditurve; prova; kërkesë për shtyrje seance, datë 13.01.2015; vendim për pranimin e kërkesës për heqje dorë, datë 23.01.2015; kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, datë 15.01.2015; kërkesë për shtyrje e seancës, datë 07.01.2016; njoftime me shpallje të renditura jo sipas datave (29.05.2015; 08.05.2015;

³² Duke evidentuar se kjo është një praktikë e mbajtur në të gjitha gjykatat e apelit të juridiksionit të përgjithshëm, që është justifikuar me ngarkesën e lartë në punë

20.04.2015); kërkesë për heqje dorë dhe vendimi i mospranimit, datë 20.05.2015; vendimi për delegimin e gjyqtari, datë 09.03.2015; aktit i shortit (*vendosur në faqen 300 të dosjes*); prova; kërkesa për përjashtim të anëtarit të trupit gjykues, datë 20.11.2015; njoftime shpallje për datat 05.02.2016, 02.10.2015; konkluzionet e paditësit; parashtrimet e të paditurit; procesverbalet e seancave gjyqësore (*të renditura jo sipas datave*) dhe vendimi përfundimtar.

Po kështu, edhe në dosjen 11, renditja e akteve në dosje fillon me aktin e shortit, vijon me konkluzionet, kërkesën për heqje dorë nga ankimi, vendimin për pezullimin e afateve të paraburgimit, kërkesën për shtyrjen e seancës gjyqësore, njoftimet për palët (*të renditura jo sipas datave*), vendimin për delegimin e gjyqtarit, procesverbalet e seancave gjyqësore (*të renditura sipas datave*) dhe vendimin përfundimtar.

Nga parashtrimet e dërguara nga gjyqtari, nëpërmjet postës elektronike rezulton se shkak për pamundësinë e verifikimit nga ana e gjyqtarit të renditjes së akteve në dosje është bërë fakti se në çështjet e verifikuara anëtarët e trupit gjykues kanë qenë gjyqtarë të komanduar nga Gjykata e Apelit Vlorë dhe Gjykata e Apelit Korçë dhe me qëllim respektimin e afateve të dorëzimit të dosjes gjyqësore, dosjet janë dorëzuar menjëherë pas marrjes së akteve të nënshkruara nga gjyqtarët e komanduar.

KONKLUZIONI

Në kushtet kur renditja e akteve në dosje, përgjithësisht, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe gjykata më e lartë, dhe parregullsia në renditjen e akteve konstatohet vetëm në dy raste, duke u vlerësuar kështu një rast i izoluar dhe që lidhet me specifikën e përmendur më lart, gjyqtari vlerësohet se ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues konkludohet se: “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short janë konstatuar mangësi në aftësinë për të administruar dosjet. Në

5 dosjet të vëzhguara mangësitë janë të njëjta : nuk ka akt formal të gjyqtarit relator për kalimin e çështjeve në seancë gjyqësore. Nuk ka relacion me shkrim nga relatori i çështjes, procesverbali gjyqësor plotëson kërkesat e ligjit procedural civil dhe penal. Në pothuajse të 5 dosjet e vëzhguara, seancat gjyqësore nuk kanë filluar në orën e planifikuar dhe në procesverbalin gjyqësor, shkaku i vonesës nuk është dokumentuar, Në 4 prej dosjeve të vëzhguara, janë inventarizuar aktet procedurale, ndërsa në dosjen 4 ky inventarizim mungon”.

Lidhur me saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes rezulton se në dosjet gjyqësore të vëzhguara ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet për çdo veprim apo seancë, kërkesat për heqje dorë nga gjykimi, procesverbalet e çdo seance, vendimet gjyqësore) si dhe aktet e paraqitura nga palët (kërkesat për shtyrje të seancës ,provat e administruara për herë te parë në gjykimin në Apel, diskutimet përfundimtare të palëve,). Nuk konstatohet mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara (me përjashtim të vendimit për nxjerrjen e çështjes në seancë gjyqësore) apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLuzioni

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë aftësie në këtë tregues, pasi pavarësisht se mungojnë në disa raste vendimet e nxjerrjes së çështjes në gjykim, kjo mungesë nuk ka sjellë asnjë pasojë procedurale në zhvillimin e çështjes dhe përfundimin e saj, pasi gjyqtari ka marrë masat për njoftimin e palëve për seancën e parë gjyqësore dhe asnjë veprim apo mosveprim nga ana e tij nuk ka ndikuar në zvarritjen apo mos zhvillimin e seancave gjyqësore efektive.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtarit”

KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	98

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave dhe i procedimeve disiplinore, nuk konstatohen të dhëna negative për etikën në punë të gjyqtarit Enton Dhimitri. Një ankesë e vitit 2016, i është regjistruar atij për vlerësim profesional dhe etik, por ajo lidhet me aftësitë organizative të tij në aspektin e gjyqimit të çështjes në kohën e duhur (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLD-së). Edhe nga vëzhgimi i 5 dosjeve nuk rezultuan të dhëna negative për etikën e gjyqtarit”.*

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Enton Dhimitri, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Në relacionin nr. 1192/1 Prot., datë 23.06.2016 të hartuar nga Inspektorati i KLD nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo praninë e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarit.

Ndërkohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 79, datë 22.11.2018, KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë që mund të ndikonin në vlerësimin lidhur me etikën e gjyqtarit, duke konkluduar se ankesat e kësaj natyre nuk rezultuan as nga denoncimet e drejtpërdrejta pranë Komisionit.

KONKLZIONI

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton asnjë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të etikës në punë.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e etikës së gjyqtarit në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter, në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se: *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit Enton Dhimitri dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
 - Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
 - Të dhënat për masa disiplinore;
 - Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, rezulton se për gjyqtarin Enton Dhimitri, në periudhën e vlerësimit, nuk rezulton të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Rezultoni se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtarin Enton Dhimitri janë paraqitur 7 ankesa (2 në vitin 2014, 1 në vitin 2015 dhe 4 në vitin 2016) në Inspektoratin e KLD-së, nga të cilat 6 ankesa janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, me arsyetimin se janë ankesa të përsëritura (2 ankesa); pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor (3 ankesa) dhe me arsyetimin se pretendimet zgjidhen në rrugë gjyqësore, ndërsa 1 (një) ankesë e vitit 2016 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe është konstatuar se gjykimi i çështjes civile, ka përfunduar tej afatit të standardit minimal të gjykimit. Në këtë rast është vlerësuar se tejkalimi i afatit nuk është bërë qëllimisht nga gjyqtari dhe është konkluduar se kjo ankesë duhet t'i regjistrohet atij për vlerësimin

profesional dhe etik. Dosja e analizuar në relacionin e Inspektoratit të KLD-së, rezulton të jetë përzgjedhur me shortin e datës 04.09.2020 për përzgjedhjen e 6 (gjashtë) çështjeve për vlerësim, konkretisht dosja nr.10, e cila është e analizuar hollësisht në faqet 25-30 të raportit. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtarit, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK-së, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI-së dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Nga analiza financiare ndër vite rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur mjete monetare të mjaftueshme për të përballuar shpenzimet e kryera. Nga pasaktësitë e konstatuara nuk lindin dyshime të arsyeshme për veprime që cenojnë figurën e gjyqtarit. Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, këto pasaktësi nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni, çmon se në këtë rast pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e prokurorit dhe as besimin e publikut tek drejtësia. Komisioni, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri, ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.”*³³

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr.79, datë 22.11.2018, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarit, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara, duke konkluduar se: *“Si përfundim, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në dijeni të rekordeve kriminale të kuartit të tij, shtetasit L. G., dhe nuk ka pasur mundësi për të deklaruar faktin në Deklaratën e Kontrollit të Figurës. Nga sa më sipër Komisioni konkludon se subjekti i rivlerësimit, z. Enton Dhimitri është i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës për sa i përket vlerësimit të kontrollit të figurës”*³⁴

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarit.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e tij.

³³ Faqe 29 e vendimit të KPK nr. 79, datë 22.11.2018.

³⁴ Faqe 29 e vendimit të KPK nr. 79, datë 22.11.2018.

Shkalla e integritetit të gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarit në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “ Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit Enton Dhimitri. Për vetë gjyqtarin Enton Dhimitri në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e tij nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 1 rast, është konstatuar se ai ka vlerësuar moshën e mitur të palës ndërgjyqëse (një prej paditësve) dhe ka zbatuar korrekt rregullat e përfaqësimit për të në gjykimi (shih dosjen 4). Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elementë të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Si në 3 dokumentet ligjore ashtu edhe në 5 dosjet e tjera të vëzhguara, nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit Enton Dhimitri nuk ka respektuar rregullat procedurale që lidhen me parimin e gjykatës së paanshme”.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtari dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtari në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të tij. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtarit.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej tij. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuuese” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Nga analiza e burimeve të vlerësimi lidhur me këtë tregues, rezulton se :

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtarit, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtari) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtarit. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësohet se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit. Prandaj, për këtë tregues numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit, vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit” është “I pakonsiderueshëm”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERA VE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

5.

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtarit në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër dhe nga përmbajtja e regjistrimeve audio të seancave gjyqësor konstatohet se komunikimi i gjyqtarit Enton Dhimitri me palët pjesëmarrëse në proces ka qënë korrekt dhe në respektim të normave etike. Në të 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në aktet është normale, komunikimi në përputhje me etikën gjyqësore dhe i qartë”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtari gjatë

komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është i qartë, transparent, i kuptueshëm. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtarit për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i tij është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre.

Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLuzioni

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtari);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtari për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtari ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtari dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “E lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit Enton Dhimitri për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Shkaku i vonesave në fillimin e seancave gjyqësore nuk është dokumentuar dhe nuk mund të konkludohet që kjo e dhënë lidhet me llojin e bashkëpunimit që ai ka patur me gjyqtarët e trupit gjykues apo me administratën gjyqësore. Nga ana tjetër, fakti që në të gjitha rastet ai ka arsyetuar në kohën e duhur vendimet gjyqësore dhe nuk ka patur vonesa administrative për depozitimin e dosjeve në sekretari është një tregues që dëshmon aftësitë e tij të bashkëpunimit dhe anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore”.*

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhënë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën

e bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me kolegët, prezumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarit gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtarit dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit apo për ekzistencën e një shkalle të ulët të komunikimit të gjyqtarit me administratën gjyqësore, gjatë periudhës së vlerësimit. Për rrjedhojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultojnë nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës së ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për këtë tregues, prezumohet se ky bashkëpunim dhe komunikim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarit me administratën

gjqësore, presumohet se gjyqtari ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarit dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, aftësia e gjyqtarit në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.*

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARIT PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Për shkak të funksionit që kryen, ai i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Në periudhën e rivlerësimit, ai ka marrë pjesë dhe është certifikuar në 15 seminare të organizuara nga Shkolla e Magjistraturës (shih të dhënat tek Trajnimet në 3 Vitet e Fundit). Këto të dhëna tregojnë se ai ka marrë pjesë në 27 ditë të formimit vazhdues për një periudhë trevjeçare. Lënda e trajnimeve, ku ai ka marrë pjesë, ka lidhje të arsyeshme me detyrën e gjyqtarit të apelit, të paorganizuar në seksione.”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARIT NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHUES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtarit.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale të Inspektoratit të KLD-së, vërtetimit me nr. 523/1 Prot., datë 20.10.2016 të Shkollës së Magjistraturës dhe formularit të vetëvlerësimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, së bashku me dokumentet shoqëruese, rezulton se ai ka marrë pjesë në Programin e Trajnimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës në cilësinë pjesëmarrësit.

Konkretisht, referuar akteve të administruara në dosjen e rivlerësimit dhe vërtetimit me nr.523/1 Prot., datë 20.10.2016, të Shkollës së Magjistraturës, gjyqtari Enton Dhimitri është angazhuar në aktivitete trajnuese në cilësinë e pjesëmarrësit në 15 aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 27 ditë trajnimi.

Për periudhën e vlerësimit nuk rezulton që gjyqtari të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtari ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese, kryesisht për tema që i përkasin të drejtës civile dhe penale, gjithsej 15 aktivitete të zhvilluara për 27 ditë, kohëzgjatje e cila është brenda kufijve 15 deri në 120 ditë, në gjithë periudhën tre vjeçare.

Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarit në aktivitetet trajnuese të Shkollën e Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, është nga 15-120 ditë, duke e pikëzuar me 20 pikë.

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARIT PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtarit në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton të jetë referuar për angazhimin e tij në veprimtari trajnuese si ekspert ose lehtësues në programin e SH.M, apo të ndonjë institucioni tjetër. Gjithashtu, nuk rezultojnë të dhëna lidhur me gatishmërinë e tij për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Enton Dhimitri ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONI

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si ekspert/lektor dhe as angazhimi i tij për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARIT NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrja në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit etj.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t’iu shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtarin Enton Dhimitri ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtarit;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtarit, nuk rezulton që gjyqtari gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Për sa më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit për gjyqtarin Enton Dhimitri ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

KONKLuzioni

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtari të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, ky tregues pikëzohet me 0 pikë.

Angazhimi i gjyqtarit dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhimi i gjyqtarit, prandaj gjyqtari vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

KRITERI	
AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

NIVELI I VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELI I PËRGJITHSHËM I VLERËSIMIT

Niveli i vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit

1. Aftësitë profesionale të gjyqtarit	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtarit	98	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Niveli i përgjithshëm i vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	389	Shkëlqyeshëm

SHTOJCA 1
KRITERET E VLERËSIMIT, SHKALLA E AFTËSISË, PIKËZIMI DHE
NIVELI I VLERËSIMIT PËR GJYQTARIN ENTON DHIMITRI
PERIUDHA E VLERËSIMIT 2013-2016

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARIT			
	Treguesit	Burimet	
A. Njohuritë ligjore	a. Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin e normave	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	b. Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
B. Arsyetimi ligjor	a. Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	Struktura e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar e vendimit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	Cilësia e analizës dhe argumentimit logjik	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
2. AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARIT			
	Tregues	Burimet	
A. Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë	a. Respektimi i afateve ligjore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %
	b. Plotësimi i standardeve minimale kohore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	0-10 %

	c. Koha mesatare që i dedikohet çdo çështje	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha kategoritë e çështjeve
	ç. Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Mbi 93-99 %
	Koha mesatare e arsytimit të vendimit përfundimtar gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short); ▪ Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar. 	Më e shkurtër se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve
B. Aftësia e gjyqtarit për të kryer procedural gjyqësore	Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre jo-produktive	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë
	Kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
C. Aftësia e gjyqtarit për të administruar dosjen gjyqësore	Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë

	Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE			
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Etika në punë	Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë
B. Integriteti i gjyqtarit	Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë
C. Paanësia e gjyqtarit	a. Përdorimi ose jo i gjuhës diskriminuese	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtarit	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	I pa konsiderueshëm
4. AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL			
Tregues		Burimi	Shkalla e aftësisë/niveli i treguesit
A. Aftësia e komunikimit	a. Komunikimi i qartë dhe transparent	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	Shumë e lartë
	Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit; ▪ Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short). 	I lartë
B. Aftësia për të bashkëpunuar	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë
	Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore	<ul style="list-style-type: none"> ▪ Dosja e rivlerësimit. 	Shumë e lartë

C. Gatishmëria e gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera	Pjesëmarrja e gjyqtarit në programin e formimit vazhdues në Shkollën e Magjistraturës dhe në trajnime të tjera profesionale	▪ Dosja e rivlerësimit.	15-120 ditë	
	Disponueshmëria e gjyqtarit për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	
	Angazhimi i gjyqtarit në veprimtari ndër-institucionale për përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	
	ç. Publikimet ligjore akademike	▪ Dosja e rivlerësimit.	Nuk ka të dhëna	
PIKËZIMI PËR KATËR KRITERET E VLERËSIMIT		389		
NIVELI PËRFUNDIMTAR I VLERËSIMIT TË GJYQTARIT		Shkëlqye		